



Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/ 74), nenit 68, paragrafit (1), pikës 5) të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15 , 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19 dhe 122/21) dhe pikat 2) dhe 3) nga Vendimi për përcaktim të radhës në të cilën viceguvernatorët do të zëvendësojnë guvernatorin gjatë mungesës së tij nga puna ose pamundësisë për të kryer detyrat gjatë vitit 2023 nr. 04-43353/1 nga 30 dhjetori 2022, Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM

për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për metodologjinë e menaxhimit me rrezikun kreditor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 57/23)

1. Në Vendimin për metodologjinë e menaxhimit me rrezikun kreditor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 146/ 20), në pikën 42), paragrafi (1), nënparagrafi (2), fjalët: "person juridik jofinanciar" (me përjashtim të shoqërive të vogla të përfshira në nënparagrafin (1) të këtij paragrafi)", zëvendësohen me fjalët: "person jofinanciar" (me përjashtim të personave fizikë dhe shoqërive të vogla të përfshira në nënparagrafin (1) të këtij paragrafi)".

2. Në pikën 52), nënpika (52.5), paragrafi (1), në fjalinë e dytë, fjala: "dallimi" zëvendësohet me fjalën: "produkti".

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

**V. nr. 02-6835/7
27 shkurt 2023
Shkup**

**Viceguvernatorja
dhe kryesuesja e Këshillit
të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
м-р Ана Митреска**